



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:245665

Datë: 18.03.2024

Numri i dokumentit: 05463845

AC.nr.8780/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin gjyqësor, në përbërje prej gjyqtarit Besnik Bislimaj kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve Faton Ademi dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtarë të kolegjit në çështjen juridike të paditëses E. S. M. nga Prishtina, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit S. N., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Telekom i Kosovës Sh.a në Prishtinë të cilën e përfaqëson sipas autorizimit N. B., për shkak të kompensimit të diferencës së pagës dhe kthimin e gradës, duke vendosur sipas ankesës së paditëses të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.3345/2018 i datës 28.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 12.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa e paditëses E. S. M. nga Prishtina, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.3345/2018 i datës 28.04.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar, C.nr. 3345/2018 datë 28.04.2021, ka vendosur: I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpapia e paditëses E. S. M., nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që “të detyrohet e paditura Posta dhe Telekom i Kosovës në Prishtinë që paditëses në emër të diferencës së pagës midis gradës 11 sa i ka takuar me kontratën e punës dhe gradës 10 sipas të cilës është bërë pagesa, për periudhën prej datës 01.01.2015 e deri me datën 21.03.2017 t’ia paguaj shumën prej 3,024.00 Euro, dhe në emër të kamatës në këtë shumë për të njëjtën periudhë shumën prej 267 Euro, e që gjithsejtë bëjnë 3,291.00 Euro, t’i paguaj në emër të Trustit Pensional në emrin e paditëses shumën prej 353.70 Euro dhe ta paguaj tatimin në pagë në emrin e paditëses shumën prej 336 Euro, krejt me kamatë prej 8% që nga data 21.03.2017 e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit me kërcënim të përmbarimit me dhunë.” II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi paditësja përmes të autorizuarit të saj, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit që ankesën e paditëses ta aprovoj në tërësi si të bazuar dhe ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar ashtu që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesë padia e paditëses, apo të njëjtin ta prishë dhe lenden ta kthej gjykatës se shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje, ose kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoje në tërësi.

Përgjigje në ankesën e paditësit nuk ka parashtruar e paditura edhe pse e njëjta me kohë është njoftuar me ankesën e paditëses.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa e paditëses është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës, rrjedh se paditësja E. S. M. nga Prishtina, në Gjykatën e shkallës së parë, me datë 25.03.2015, ka paraqitur padi, për anulim vendimi dhe kompensimin e pagave në emër të diferencës së pagës si dhe kthimin e gradës, ndaj të paditurës Telekom i Kosovës Sh.a në Prishtinë, me kërkesë të precizuar si në parashtrësën e datës 03.05.2017.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor, dëgjimit të palëve ndërgjyqëse si dhe administrimit të provave, ka marrë aktgjykimin C.nr. 710/2015 datë 13.12.2017, me të cilin ka aprovuar në tërësi kërkesë padinë e paditëses si të bazuar, duke vendosur konkretisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit që ankesën e të paditurës ta aprovoj në tërësi si të bazuar dhe ta prishë aktgjykimin e ankimuar dhe lenden ta kthej gjykatës se shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje, ose kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoje në tërësi.

Gjykata e Apelit me aktgjykimin AC.nr. 1686/2018 datë 27.06.2018, ka refuzuar ankesën e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi C.nr. 710/2015 datë 13.12.2017.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura brenda afatit ligjorë ka parashtruar Revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore si dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoj në tërësi si të bazuar revizionin e të paditurës dhe aktgjykimet e gjykatës së Apelit dhe atë të gjykatës së shkallës së parë të prishë dhe çështjen ta kthej në ri procedurë dhe ri vendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës, me aktvendimin Rev.nr. 298/2018 datës 23.10.2018, ka aprovuar si të bazuar revizionin e të paditurës dhe i ka prishur aktgjykimin e Gjykatës së Apelit AC.nr.

1686/2018 datë 27.06.2018 dhe atë të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr. 710/2015 datë 13.12.2017 dhe lënda është kthyer në gjykatën e shkallës së parë në ri procedurë dhe ri vendosje, duke i dhënë udhëzimet e nevojshme për gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së parë në ri procedurë, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor, dëgjimit të palëve ndërgjyqëse si dhe administrimit të provave, ka marrë aktgjykimin C.nr. 3345/2018 datë 28.04.2021, me të cilin ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur konkretisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e shkallës së parë, në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar ndër të tjera ka arsyetuar se: Ashtu siç u theksua edhe më lartë, paditësja ka kërkuar nga gjykata që të detyroj të paditurën që paditëses në emër të diferencës së pagës midis gradës 11 sa i ka takuar me kontratën e punës dhe gradës 10 sipas të cilës është bërë pagesa, për periudhën prej datës 01.01.2015 e deri me datën 21.03.2017 t'ia bëj kompensimin e diferencës në pagë/gradë. Në kontratën nr. 01-6182-680/14, e datës 31.12.2014 që paraqet edhe kontratën e parë me gradë 10 të paditëses tek e paditura, janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet reciproke të palëve nënshkruese në cilësinë e tyre si punëdhënës dhe punëmarrës. Gjykata vlerëson se kontrata është në harmoni të plotë me dispozitat e Ligjit të Punës përkatësisht me kërkesat ligjore të paraqitura në nenin 11 të Ligjit të Punës, përmbajtja e të cilit u paraqit tek baza ligjore në këtë arsyetim. Në rastin konkret, palët me kontratë përkatësisht me nenin 5 të kontratës kanë përcaktuar se të punësuarit – paditëses i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin në lartësi të gradës 10. Meqenëse lidhja e kontratës së punës ishte në pajtim me dispozitat ligjore, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar.

Më tej ka theksuar se: E drejta e kompensimit të të ardhurave personale paditëses në rastin konkret do t'i takonte vetëm në situatën kur paditësja do të arrinte të argumentonte me prova relevante pranë gjykatës se kontrata e punës është lidhur në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Përkatësisht, neni 46 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve shprehimisht përcakton se pala e cila është në lajthim mund të kërkojë të shpallet e pavlefshme kontrata e punës për shkak të lajthimit thelbësor, përveç nëse gjatë lidhjes së kontratës nuk ka vepruar me kujdesin që kërkohet në qarkullim dhe se nëse kontrata shpallet e pavlefshme për shkak të lajthimit, pala tjetër me mirëbesim ka të drejtë të kërkojë shpërblim për dëmin e pësuar. Paditësja nuk ka pretenduar se e njëjta ka qenë në lajthim me rastin e lidhjes së kontratës, rrjedhimisht duke mos e pasur një qëndrim të tillë, i njëjti as nuk është argumentuar.

Më tej ka theksuar se: Gjykata ka vlerësuar se kushtet e kontratës së punës të lidhur mes paditëses dhe të paditurës, duke përfshirë edhe lartësinë e pagës përkatësisht gradën sipas së cilës do të paguhet paga e paditëses janë në harmoni të plotë me dispozitat e Ligjit të Punës. Sipas vlerësimit të gjykatës marrëdhënia e punës është marrëdhënie kontraktore ku palët duhet të respektojnë kushtet për lidhjen e kontratës. Gjykata vlerëson se kontrata e punës e lidhur mes paditëses dhe të paditurës është një marrëdhënie kontaktuese e krijuar në tërësi duke i respektuar kushtet e përgjithshme për lidhjen e kontratës dhe atë “aftësia punuese e palëve kontraktuese, (aftësia gjegjësisht mosha madhore), vullnetin e palëve, lënda e kontratës dhe baza e kontratës. Është rregull i përgjithshëm dhe parim i së drejtës, se palët me vullnetin e tyre të lirë e të shprehur mund të krijojnë raportin juridik, përkatësisht marrëdhëniet juridike. Në rastin konkret gjykata

ka vlerësuar se kontrata e punës e lidhur në mes paditëses dhe të paditurës është lidhur për shkak se ka ekzistuar vullneti i shprehur i të dy palëve kontraktuese. Meqenëse nga provat e administruara ka rezultuar se paditësja dhe e paditura me kontratë janë pajtuar për lartësinë e pagës mujore të paditëses me gradë 10, gjykata vendosi që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë si të pabazuar.

Më tej ka arsyetuar se: Sa i përket vendimeve në të cilat është thirrur paditësja se në raste të tjera - bazuar në praktikën gjyqësore - gjykatat kanë aprovuar kërkesa të tilla, megjithëse gjykata nuk është e lidhur për praktikën gjyqësore në rastet kur çështjet e caktuara janë të rregulluara shprehimisht me dispozita ligjore, megjithatë, gjykata thekson se të njëjtat kanë të bëjnë me rastet kur nuk ka pasur një kontratë të re të punës dhe pagesa e pagës është bazuar vetëm mbi vendimin e lëshuar nga ana e të paditurës, i cili vendim pastaj do të mund të konsiderohej si arbitrar, varësisht nga rasti në rast. Megjithatë, përderisa paditësja ka nënshkruar kontratën e re të punës në vitin 2014, është pajtuar me kushtet e paraqitura aty, ashtu siç kjo është përcaktuar edhe në nenin 20 të kontratës, e njëjta është palë e barabartë me të paditurën në nënshkrimin e të njëjtës dhe nuk kemi të bëjmë me një vendim të një-anshëm por kemi të bëjmë me marrëdhënie kontraktuale të krijuar mes palëve tani ndërgjyqëse. Neni 10, paragrafi 1, i Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, tash e tutje referuar si “Ligji i Punës” shprehimisht përcakton se “kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuari. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të [Ligjit të Punës].”, ndërsa neni 11, i Ligjit të Punës përcakton kushtet se çka duhet të përmbajë një kontratë e punës. Ndër të tjera, në këtë dispozitë ligjore, në paragrafin 1.8 është përcaktuar si një ndër kushtet thelbësore të kontratës së punës edhe “lartësia e pagës bazë, si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjetër”, gjithashtu neni 55, paragrafi 1, i Ligjit të Punës përcakton se “i punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit.” Tutje, neni 55, paragrafi 2 i Ligjit të Punës shprehimisht përcakton se: “të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës.”

Më tej ka arsyetuar se: Sa i përket pretendimit të të paditurës se kërkesëpadia e paditëses është e parashkruar, ky pretendim nuk qëndron. Kjo për shkak se kërkesëpadia e paditëses ka të bëjë me kërkesë në të holla e cila mbulohet qartë me dispozitën e nenit 87, të Ligjit të Punës. Rrjedhimisht, gjykata konstaton se kërkesëpadia e paditëses nuk është e parashkruar, megjithatë, e njëjta është e pabazuar, për arsye që u paraqitën në këtë arsyetim.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar të pa bazuara pretendimet ankimore të paditëses, aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të procedurës kontestimore të pretenduara me ankesë. Aktgjykimi i ankimuar nuk ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktgjykimit është i qartë i kuptueshëm dhe nuk është kontradiktor me vetë veten dhe as me arsyet e aktgjykimit. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftuara për faktet vendimtare, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar të pa qëndrueshme pretendimet ankimore të paditëses në lidhje me konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që Gjykata e Apelit konstaton se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe plotësisht e ka konstatuar gjendjen faktike, pasi që nuk ishte kontestuese se paditura në cilësinë e punëdhënësit kanë lidhur kontratë me nr. 01-6182-680/14, e datës 31.12.2014 me paditësen. Sipas kontratës së punës paditësja pranë të paditurës përcaktohet se do të kryejë detyrat e punës Kordinator i Zyrës së Ambasadave - PTK. Sipas nenit 5 të kontratës është përcaktuar se të punësuarit (paditëses), i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin në lartësi të gradës 10. Gjithashtu është vërtetuar se paditësja dhe e paditura, kanë nënshkruar kontratën e re të punës, me afat të pacaktuar me nr. 01-5740-272/2015 në të cilën - ndër të tjera - ishte përcaktuar edhe paga e paditëses pranë të paditurës. Përkatësisht, në nenin 5 të kësaj kontrate është përcaktuar se paditëses i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin në lartësi të gradës 10, sipas vendimit të bordit të përkohshëm të drejtorëve të PTK-së, nr.01-1630/05, datë 28.02.2005. Pasi që gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike gjeti se kërkesëpadia e paditëses nuk është e bazuar, sepse paditësja dhe e paditura raportin e tyre punëdhënës-punëmarrës e kanë rregulluar me kontratë duke përcaktuar të drejta dhe detyrime reciproke në mes tyre, andaj gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditëses për periudhën kontestuese për kompensimin e diferencës së pagave të papaguara është e pabazuar, pasi paditësja është pajtuar me gradën e pagës kur e ka nënshkruar kontratën e punës.

Gjykata e Apelit, vlerëson se mbi bazë të gjendjes faktike të konstatuar, drejtë dhe plotësisht drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale ku gjykata ka vlerësuar se kushtet e kontratës së punës të lidhur mes paditëses dhe të paditurës, duke përfshirë edhe lartësinë e pagës përkatësisht gradën sipas së cilës do të paguhet paga e paditëses janë në harmoni të plotë me dispozitat e Ligjit të Punës. Me nenin 10, paragrafi 1, i Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, tash e tutje referuar si “Ligji i Punës” shprehimisht përcakton se “Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuarit. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të Ligjit të Punës.”, ndërsa neni 11, i Ligjit të Punës përcakton kushtet se çka duhet të përmbajë një kontratë e punës. Ndër të tjera, në këtë dispozitë ligjore, në paragrafin 1.8 është përcaktuar si një ndër kushtet thelbësore të kontratës së punës edhe “lartësia e pagës bazë, si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjetër”, gjithashtu neni 55, paragrafi 1, i Ligjit të Punës përcakton se “I punësuarit ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit.” Tutje, neni 55, paragrafi 2 i Ligjit të Punës shprehimisht përcakton se: “të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuarit i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës. Andaj, sipas vlerësimit të gjykatës së Apelit marrëdhënia e punës është marrëdhënie kontraktore ku palët duhet të

respektojnë kushtet e kontratës. Në rastin konkret gjykata ka vlerësuar se kontrata e punës e lidhur në mes paditësit dhe të paditurës mund të ndryshojë vetëm me vullnetin e shprehur të të dy palëve kontraktuese.

Gjykata e Apelit i vlerëson pretendimet ankimore të paditëses në lidhje me atë se vendimi i bordit të përkohshëm të drejtorëve të PTK-së, nr.01-1630/05, datë 28.02.2005 tani më është shfuqizuar dhe nuk mund të prodhojë efekt juridik, por të njëjtat pretendime nuk i morri për bazë, pasi që për gjykatën e Apelit në këtë çështje kontestimore nuk ka relevancë nëse vendimi i bordit të përkohshëm të drejtorëve të PTK-së, nr.01-1630/05, datë 28.02.2005, është në fuqi apo jo pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë me kontratë të punës dhe se palët kontraktuese janë marrë vesh për të drejtat dhe detyrimet e tyre e gjithashtu kanë përcaktuar edhe pagën bazë dhe lartësinë e gradës e që në rastin konkret kanë përcaktuar gradën 10.

Gjykata e Apelit i vlerësoj edhe pretendimet tjera të paditëses të parashtruara me ankesë, por të njëjtat nuk i morri për bazë pasi që vlerëson se të njëjtat nuk kanë ndikim në vendosjen ndryshe në ankesën e paditëses.

Nga të lartcekurat më lartë, e në mbështetje të nenit 195 paragraf. 1 pika e), e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.8780/2021, me datë 12.03.2024

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari
Besnik Bislímaj, d.v